



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1370_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2163_04_21** i dt. **16.04.2021**;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **12.05.2021**.

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin N.S nga Komuna e Istogut, me shifër të konsumatorit DPE - 9060341, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2163_04_21, i datës 16.04.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 16.04.2021 ka marrë Vendim me nr.ZRrE/DMK_V_2163_04_21, me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit N.S nga Istogu dhe e ka obliguar KESCO-n që ta anulojë faturën e dt.25.12.2017 në vlerë prej 472.35 €, dhe se për këtë periudhë ta ngarkoj konsumatorin me shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës 03/2018 (TL=94 kWh dhe TU=45 kWh).

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka parashtruar Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- konsumatori ka bërë kyçje ilegale pa pëlqimin e ndërmarrjes së energjisë dhe ka krijuar shpenzim të paautorizuar;
- pasi që nuk dihet saktë data e kyçjes, atëherë edhe shpenzimi i krijuar nuk përfshin shpenzimin vetëm për një muaj por për një periudhë më të gjatë kohore.
- ZRrE nuk e ka marrë parasysh faktin se njehsori nr.1402052232 ka qenë i kyçur në mënyrë ilegale, nuk ka qenë i lajmëruar dhe nuk e ka pasur pëlqimin për kyçje nga ndërmarrja e energjisë;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2163_01_21 i datës 16.04.2021 për konsumatorin N.S.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që konsumatori ka bërë kyçje ilegale dhe ka krijuar shpenzim të paautorizuar të energjisë, Bordi i ZRrE-së thekson se ky argument nuk është relevant në rastin konkret, pasi që **shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është vepër penale** sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, respektivisht në kapitullin e XXVI – Vjedhja e Shërbimeve, neni 314, një veprim i tillë është i inkriminuar si vepër penale. Rrjedhimisht, ZRrE nuk ka kompetencë në trajtimin e këtyre rasteve, pasi që për vepra penale, kompetente janë institucionet tjera të sistemit të drejtësisë.

Lidhur me pretendimin se ekipet e KEDS-it e kanë verifikuar pikën matëse dhe konstatuar kyçje ilegale në rrjet të njehsorit nr.1402052232 me gjendje TL=5536 kWh dhe TU=2093 kWh, të dt.18.09.2017, Bordi e ka vlerësuar si të paqëndrueshëm, për faktin se një procesverbal i tillë **nuk është** bashkëngjitur në shkresat e lëndës, e po ashtu, nëse e marrim për bazë faktin se me datë 09.11.2017, me procesverbalin e pranimit të njehsorit elektrik nr.0135957, njehsori i njëjtë, është evidentuar me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, si dhe kanë theksuar se **teknikisht është në rregull**.

Në të njëjtën kohë, ekziston një paqartësi faktike lidhur me rastin në fjalë, pasi që për konsumatorin N.S, punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr.1402052232 dhe atë me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh, dhe në muajin 11/2017 është faturuar pa shpenzim, por vetëm me taksa fikse, dhe se menjëherë, në muajin 12/2017, konsumatori është faturuar me shpenzim të energjisë elektrike **prej 7667 kWh, dhe atë si shpenzim mujor**. Po ashtu, duhet theksuar se konsumatori pas periudhës kontestuese, në disa periudha ka shpenzim jashtëzakonisht të ulët, e në disa periudha tjera nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike të faturuar. Edhe sikur të pjesëtohej shpenzimi i energjisë elektrike i periudhës 12/2017, prej 7,667 kWh me mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike pas periudhës kontestuese, i bie që ai njehsor të jetë montuar për afro 20 vite më parë, e jo vetëm një muaj siç edhe është konstatuar nga punëtorët e KEDS-it. Andaj, me të drejtë, organi i shkallës së parë në ZRrE, pra DMK, ka konstatuar se shpenzimi i periudhës 11/2017 prej 7,667 kWh nuk paraqet shpenzim real, dhe se për këtë muaj, konsumatori duhet të ngarkohet me shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës 03/2018.

Deri tek ky konstatim, Bordi i ZRrE-së ka ardhur duke administruar provat si në vijim: Procesverbalin e inspektimit nr.2063304 i datës 12.05.2018 dhe rrjedhën e energjisë aktive, procesverbalin e pranimit të njehsorit elektrik nr.0135957 i datës 09.11.2017, listat e leximit prej periudhës 11/2017 dhe 08/2018 dhe rrjedhën e energjisë aktive. Bazuar në këto prova, Bordi ka vlerësuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të pikës matëse, shpenzimi mesatar i energjisë për vitin 2018 është 46 kWh/muaj, për vitin 2019 është 16.97 kWh muaj, për vitin 2020 është 0 kWh/muaj. Pra, nga sa u tha më sipër, shihet qartë që shpenzimi i energjisë elektrike i konsumatorit i faturuar në periudhën 12/2017, me 7667 kWh si shpenzim mujor, nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimin e konsumatorit të periudhave pas kontestit.

Andaj, duke u bazuar në nenin 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji: **“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e**



aplikueshme). **2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”, pastaj në nenin 54 të Ligjit për Energjinë Elektrike “Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë” dhe duke u bazuar në nenin 3.5.1 të Kodit të Matjes, KEDS dhe KESCO është dashur që menjëherë të bëjnë ndërrimin e njehsorit dhe të verifikojnë pikën matëse, pasi që sipas dispozitave të lartcekura, operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të njehsorëve është përgjegjësi e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.**

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit N.S. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së